



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:102239
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05693597

K.Dh.SHk.II.nr.963/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit A.A.B. B.I. me seli Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Sh.S., kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës së paditëses të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.192/2024 të datës 04.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit - propozuesit A.A.B. B.I me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr. 192/2024 të datës 04.04.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.192/2024 të datës 04.04.2024 është refuzuar propozimi - kërkesa e paditësit – propozuesit A.A.B. B.I. me seli në Prishtinë, sipas të cilës ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar - vendimit me nr. prot.36/2024 të datës 24.02.2024, të të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi - propozuesi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e propozuesit si e bazuar ashtu që Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale ta ndryshojnë aktvendimin e Gjykatës Komerciale KF.nr.192/2024 të datës 04.04.2024 ashtu që të shtyhet ekzekutimi i vendimit me nr. prot. 36/24 të datës 24.02.2024, deri në vendosjen përfundimtare.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenit 194 të LPK-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi A.A.B. B.I. me seli në Prishtinë, përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, me të cilën ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, kundër vendimit nr. prot.36/2024 të datës 24.02.2024. Paditësi me padi, ka kërkuar edhe shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Departamentit të Ankesave të ATK-së, nr. prot.36/2024 të datës 24.02.2024.

Duke vepruar sipas propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ, gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrje e ekzekutimit të vendimit kontestues ATK-së, nr. prot.36/2024 të datës 24.02.2024, ka gjetur se propozimi i tillë është i pabazuar, ngase paditësi, nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë të vetme pretendimin e tij, se me ekzekutimin e vendimit të paditurit, i njëjti do ti sillte dëm i cili vështirë do të riparohej dhe se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kusht ky ligjor i cili duhet të provohet nga paditësi, për të shtyrë pastaj gjykata ekzekutimin e vendimit të kontestuar. Andaj, gjykata gjatë vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, iu ka referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par. 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë ligjore është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Në rastin konkret është evident fakti se propozuesi – paditësi me ankesën e ushtruar kërkon që të ndalohej ekzekutimi i aktvendimit nr. prot.36/2024 të datës 24.02.2024, të të paditurit ATK, deri në vendosjen përfundimtare të çështjes. Sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj gjykate, në bazë të shqyrtimit të shkresave gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar propozimin për shtyrjen e ekzekutimit ngase paditësi ankesës nuk i ka bashkangjitur prova të mjaftueshme

mbi të cilën gjykata e shkallës së parë do të mund të shqyrtonte kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës. Në një gjendje të tillë të çështjes Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë vlerëson se paditësi me rastin e parashtrimit të propozimit për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ, propozimit nuk i ka bashkangjitur prova të mjaftueshme me të cilën do të mund të mbështetet kushti ligjor për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Së këndejmi, është vlerësim i kësaj gjykate, se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka arsyetuar se dokumentet e bashkangjitura në asnjë rrethanë nuk dëshmojnë se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, se ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues, por se këto dokumente janë prova që trajtohen dhe vlerësohen me rastin e shqyrtimit të padisë dhe vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues. Pra, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka refuzuar propozimin e paditësit ngase i njëjti nuk ka bashkangjitur prova materiale mbi të cilat do të argumentonte para gjykatës se akti kontestues do t'i sillte dëm vështirë të riparueshëm paditësit. Thëniet në ankesë janë referim i fakteve të cilat nuk mund të merren si bazë faktike për të formësuar bindjen e gjykatës për një pretendim të caktuar, pa u mbështetur me prova konkrete materiale. Ndërkaq aktet dhe dokumentet të cilat pala i ka bashkangjitur padisë nuk argumentojnë se paditësi eventualisht dëmtohet, i cenohen interesat apo se shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik.

Dhomat e Shkallës së Dytë i trajtuan edhe pretendimet ankimore, në veçanti ato që ndërlidhen me rrezikun e menjëhershëm dhe të riparueshëm të paditësit – propozuesit i cili vështirë do të riparohej. Në këtë drejtim, Kolegji ka shqyrtuar shkresat e lëndës mirëpo nuk ka gjetur një provë të vetme që i jep të drejtë palës për t'iu aprovuar kërkesa e palës, aq më tepër për faktin se vet paditësja ka hyrë në marrëveshje për pagesën e borxheve tatimore me këste. Sipas Kolegjit, referimet në ankesë janë pretendime mbi faktet të cilat paditësi kërkon të vërtetohen në gjykatë, por që të njëjtat nuk shqyrtohen me rastin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit. Po ashtu pretendimet për zbatim të gabuar të drejtës materiale janë të pabazuara, ngase në këtë fazë gjykata e shkallës së parë nuk lëshohet në gjykimin meritore të kërkesës andaj zbaton vetëm dispozitën e Nenit 22 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji gjene se, Aktvendimit i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Numri i lëndës: 2024:102239
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05693597

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.963/2024, me datë 16.05.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova